



Data: 11.02.2019

Ref.: 180/190

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25. 05. 2016), Nenit 7 dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit, Nr.1409/18, datë 25.10.2018 për akreditim të programeve të studimit:
 - Edukim, PhD, 180 ECTS
 - Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (0-3 vjeç), BA, 240 ECTS.

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit (tash e tutje Fakulteti i Edukimit) ka parashtruar kërkesë (Nr.1409/18, datë 25.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim të dy programeve të studimit si në vijim: Edukim, PhD, 180 ECTS, dhe Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç), BA, 240 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Fakultetit të Edukimit, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të këtij neni, ku thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, erdhi në përfundim se programet e studimit, Edukim, PhD, 180 ECTS Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç), BA, 240 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

1. Për programin e studimit: *Edukim, PhD, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Fakulteti i Edukimit ka paraparë tre persona: Blerim Saqipi, Zeqir Veselaj, dhe Fatlume Berisha-Sejdiu.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.* Programi i studimit *Edukim, PhD, ka 180 ECTS*, dhe rrjedhimisht duhet ti ketë të paktën tre persona me gradën akademike PhD, nga fusha e programit të studimit. Ky program i përket nivelit të doktoratës, dhe përveç kushteve të referuara më lart sipas dispozitave ligjore, të parapara në nenit 26, pika 5.3.6 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të doktoratës që shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Dr.sc., kërkesat për staf akademik janë që për çdo program të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën tre (3) staf në marrëdhënie të rregullt të punës me titullin akademik Prof. Asoc. Dr. ose Prof. Dr. nga fusha e programit të studimit”.*

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik për këtë program të studimit, u konstatua që Blerim Saqipi nuk i përmbush kriteret ligjore për të qenë bartës në këtë program studimi, pasi që i njëjti ka thirrjen akademike Prof. Ass (Profesor Asistent). Përveç kësaj, Fatlume Berisha-Sejdiu, sipas vendimit të nostrifikimit të diplomës të lëshuar nga MASHT, (datë 29.03.2013) thuhet: Fatlume Berisha-Sejdiu i njihet grada universitare PhD në Shkencat e Natyrës, drejtimi Kimi. Andaj mbi këtë bazë e njëjta nuk mund të jetë bartëse e programit në *Edukim, niveli PhD*.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë KShC vendosi, që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit dhe mosplotësimit të kriterit formal për gradën akademike, ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Edukim, PhD, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç), BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi Fakulteti i Edukimit ka paraparë tre persona: Rozafa Ferizi Shala (PhD në Shkenca Pedagogjike), Albulena Metaj Macula (PhD në Shkencat e Psikologjisë), Xhavit Beqiri (PhD në Shkencat Filologjike), dhe Agnesa Çanta.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.* Programi i studimit *Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç), BA, ka 240 ECTS*, dhe rrjedhimisht duhet ti ketë të paktën katër persona me gradën akademike PhD, nga fusha e programit të studimit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që Agnesa Çanta nuk ka nostrifikim (njohje të diplomës nga MASHT) të diplomës. Sipas


Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: “për qellim të punësimit, këto diploma duhet të notifikohen nga MASHT”. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës së studimeve të doktoratës, e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit: *Edukimi, dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç), BA, 240 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë